



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Manuali i përdorimit

Menaxhimi i aplikimeve për provimin e
maturës

Tabela e përmbajtjes

Identifikimi në sistem.....	1
Shërbimet	3
Menaxhimi i aplikimeve për provimin e maturës	4
Lista e aplikimeve	5
Lista e aprovimeve	7

Identifikimi në sistem

Hyrja

Hapat e përdorimit:

1. Vegza për qasjen në sistem: <https://ekosovams.rks-gov.net/>
2. Në ekran shfaqet mënyra e qasjes në sistem si në foton [Fig.1.0].
3. Pasi të jetë hapur dritarja, fushat “Përdoruesi” dhe “Fjalëkalimi” duhet të plotësohen me të dhëna nga përdoruesi i cili ka qasje në sistem.
4. Pas përfundimit duke klikuar butonin “Hyr”, nëse të dhënat e përdoruesit janë të sakta, në ekran hapet faqja e parë, pas identifikimit të suksesshëm shfaqen mundësitë e menaxhimit të platformës që i përkasin përdoruesit [Fig. 1.1].

Ilustrimet:

Ilustrimet:

Fig.1.0

Fig.1.1


Shërbimet

Përshkrimi: Përdoruesi duhet të klikojë mbi “Button” me emërtimin “Shërbimet” ku më pastaj do të drejtohet tek dritarja e konfigurimeve për “Shërbimet”, që shihet në fotografinë [Fig. 2.0].

Brenda kësaj dritare, përdoruesi do të ketë mundësinë e përdorimit të shërbimit:

- Menaxhimi i aplikimeve për provimin e maturës

Ilustrimet:



[Fig.2.0]


Menaxhimi i aplikimeve për provimin e maturës

Përshkrimi: Përdoruesi duhet të klikojë mbi “Button” me emërtimin “Menaxhimi i aplikimeve për provimin e maturës” ku më pastaj do të drejtohet tek dritarja e konfigurimeve për “Menaxhimi i aplikimeve për provimin e maturës”, që shihet në fotografinë [Fig. 2.0].

Brenda kësaj dritare, përdoruesi do të ketë mundësinë e përdorimit të nënshërbimeve si:

1. Lista e aplikimeve
2. Lista e aprovimeve

Ilustrimet:



[Fig 2.1]

Lista e aplikimeve

Përshkrimi: Dritarja për listimin e aplikimeve shërben për të paraqitur listën e aplikimeve për paraqitjen e provimit të maturës. Aplikimi për provimin e maturës ka mundësinë e aprovimit apo refuzimit të aplikimit [Fig 2.2].

Hapi 1. Aplikimi për paraqitjen e provimit të maturës mund të aprovohet duke klikuar mbi “Button” me emërtimin “Aprovo”.

Hapi 2. Aplikimi për paraqitjen e provimit të maturës mund të refuzohet duke klikuar mbi “Button” me emërtimin “Refuzo”.

Pasi të jetë klikuar butoni “Refuzo”, shfaqet një dritare ku duhet të ceket arsyeja e refuzimit.

Nëse nuk klikojmë mbi kutinë zgjedhëse (checkbox) me përshkrimin “T’i ndalohet përmirësimi” studenti ka mundësinë që të përmisojë aplikimin e tij në bazë të arsyes së refuzimit të dhënë. Në të kundërtën nëse kutia zgjedhëse (checkbox) është e zgjedhur, studenti nuk e ka kaluar vitin dhe nuk ka të drejtë që ti nënshtrohet provimit të maturës apo të aplikojë për provimin e maturës deri në afatin tjetër.

Për të përfunduar me refuzimin përdoruesi duhet të klikojë mbi “Button” me emërtimin “Refuzo” [Fig 2.3].

Ilustrimet:

Lista e aplikimeve për provimin e matures

ID	Studenti	Shkolla	Drejtimi	Nr. Klases	Nr. Ditarit	Viti diplomi...	Gjuha e pro...	Drejtimi na...	Data apliki...	Me aftësi të kuf...	
1...	Arbër Mirena	Hajdar Dushi	Shkenca Shoqërore dhe Gjuhësore	12/3	23	2017	Shqip	Jo	15.05.2024 16.26	☐	REFUZO APROVO

1 - 1 prej 1 rezultateve

[Fig 2.2]

Shenoni arsyen e refuzimit

Shkruaj këtu

☐ Ti ndalohej për mirësimin


REFUZO

[Fig 2.3]

Lista e aprovimeve

Përshkrimi: Dritarja për listimin e aprovimeve shërben për të paraqitur listën e aplikimeve të aprovuara për provimin e maturës. Në listë shfaqen të dhënat e detajuara të aplikimit [Fig 2.4].

Ilustrimet:



ID	Studenti	Drejtimi	Nr. Klases	Nr. Ditarit	Viti diplomimit	Gjuha e provimit	Me nevoja te veqanta	Data aplikimit
1...	Arbër Mirena	Shkencë Shoqërore dhe Gjuhësore	12/3	23	2017	Shqip	Jo	15.05.2024 16:26

[Fig 2.4]

Për çdo informatë kontaktoni në numrin e telefonit:
Driton R. Gashi
+383 (0)44 171 475